REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorëzuar<br>Primljeno/Predato<br>Recieved/Delivery | 15 - 10 - 2018 | | |
|---|---|---|---|
| Organ./Njësia<br>Organ./Jedinica<br>Org./Unit | Nr.Prot:<br>Br.Prot:<br>Prot.No: | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Količina<br>Quantity |
| SKPMSHCK | 6012/2018 | | 1/3 |

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A nr.533/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –** Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Gjylinaze Gola dhe Lulzim Aliaj-anëtar, dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e larte per bashkëpunim profesional, ne cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A. nr.533/2018, të datës 16.08.2018, të ankuesit Përparim Rexhepi nga Komuna e Kllokotit, kundër organit të punësimit Komuna e Kllokotit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.10.2018, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.533/2018 e datës 16.08.2018, e parashtruar nga ankuesi Përparim Rexhepi.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr. prot: 10771/3 të datës 20.07.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kllokotit.

**III.** Vendimi hynë ne fuqi ne ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

### A r s y e t i m

Ankuesit Përparim Rexhepi i punësuar sipas akt emërimit të datës 01.06.2015 në pozitën "Menaxher i Prokurimit" në Komunën e Kllokotit, me datën 31.05.2018, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i shqiptohet masë disiplinore vërejtje me shkrim, duke e vendosur në dosjen personale.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen e shqiptuar nga Kryetari i Komunës, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë, me datën 27.06.2018 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 10677/3, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Kllokotit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Kllokotit, me datën 20.07.2018 ka nxjerr vendimin me numër protokolli 10771/3, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi Përparim Rexhepi, i pakënaqur me vendimin e datës 20.07.2018, me numër protokolli 10771/3, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Kllokotit, me

datën 16.08.2018 parashtron ankesën me numër protokolli 4746/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankueses e ka proceduar tek Komuna e Kllokotit për përgjigje në ankesë me datë 28.08.2018. Ndërsa me datën 10.09.2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

**Administrimi i provave:** Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokolli 4746/2018 e datës 16.08.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 20.07.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vërejtja e shqiptuar për ankuesin e datës 31.05.2018, nga Kryetari i Komunës së Kllokotit; Ankese e ankuesit e datës 27.06.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbal i datës 31.05.2018; Ankese e ankuesit e datës 12.06.2018, drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ne Komunën e Kllokotit; Procesverbal i datës 02.07.2018, Njoftim i datës 04.07.2018; Vendim i datës 03.07.2018; Vendim i datës 27.06.2018; Vendim i datës 04.07.2018; Kërkesë për dalje gjate orarit te punës e datës 29.05.2018; Kërkesë e datës 11.06.2018; Ftesë e datës 20.07.2018; Kërkesë për përgjigje e datës 28.08.2018, e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës; Akt emërim i ankuesit i datës 25.06.2018; Akt emërim i ankuesit i datës 01.06.2018;Procesverbal i datës 18.07.2018; Deklarate e datës 29.08.2018; Deklarate e datës 29.05.2018; Përgjigje në ankesë e Komunës së Kllokotit e datës 10.09.2018, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Perparim Rexhepi, **është e pabazuar**, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor te ankuesit i cili pretendon se vërejtja e shqiptuar nga eprori i drejtpërdrejte është në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedura Disiplinore në Shërbimin Civil, ka konstatuar se janë te pa qëndrueshme pasi që ankuesi me datën 29.05.2018 nga ora 09:30 deri ne orën 11:00, e ka lëshuar vendin e punës puna pa leje paraprake tw eprorit të drejtpërdrejtë, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesi me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"2. Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, i ka shqyrtuar dhe analizuar edhe deklaratat e Drejtorit, të Drejtorisë së Arsimit, Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe rojës se sigurimit, me të cilat dëshmohet se nëpunësi civil Përparim Rexhepi, me datën 29.05.2018, ka munguar nga vendi i tij i punës prej orës 09:30 deri në orën 11:00, andaj këtë veprim juridik për mungesën ne punë nëpunësi civil e ka ndërmarr ne kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se vërejtja me shkrim e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Kllokotit është shqiptuar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedura Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Vërejtja e shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejte, shqiptohet ne proporcion me pasojat e shkaktuar dhe vendoset në dosjen personale të nëpunësit civil"* .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cila pretendon se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj pasi që nuk kam bërë asnjë shkelje ligjore, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kllokotit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 10771/3 të datës 20.07.2018 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

***Këshillë juridike:*** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**
**Lënda me numër A nr.533/2018;**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**
**Kryetare e Kolegjit**

**Ardita Perçuku-Shyti**
**Procesmbajtëse**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit Përparim Rexhepi;*
- *Kryetarit të Komunës së Kllokotit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kllokotit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*